

Oda Ekonomike e Kosovës


Statistikat tregtare të Kosovës me Shqipërinë, 2015 - 2024

Bilanci tregtar i mallrave me Shqipërinë në milion Euro


Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, deficitit tregtar u zvogëlua me 14.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, duke arritur në -168.1 milion euro nga -196.0 milion euro. Mbulueshmëria e importit nga eksporti arriti në 50.3%.

Gjatë periudhës 2021-2024, eksportet e Kosovës shënuan një rritje mesatare vjetore prej 13.3% (124.4 milion €), ndërsa importet shënuan një rritje mesatare vjetore prej 16.4% (292.4 milion €).


Shqipëria nga viti në vit zë një vend të rëndësishëm në eksportin e Kosovës, duke përfaqësuar 18.1% të eksporteve totale në 2024 (170.0 milion €), me një mesatare vjetore prej 14.3% për 2021-2024. Importet nga Shqipëria arritën në 338.2 milion € (5.3% e importeve totale), me një mesatare të njëjtë gjatë periudhës 2021-2024.



Eksportet sipas seksioneve - grup kapitujve, në % gjatë vitit 2024



Importet sipas seksioneve - grup kapitujve, në % gjatë vitit 2024



Sipas të dhënave nga Open DATA, Doganat e Kosovës, eksportet kryesore për 2024 përbëhen nga: produktet minerale (23.2%), ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani (20.6%), metalet bazë (18.0%), etj.

Në import, grupet kryesore janë: produktet minerale (39.1%), metalet bazë (31.6%), produktet vegjetale (8.2%), ushqimet e përgatitura dhe pijet (6.6%), etj.

Përgatitur nga: Oda Ekonomike e Kosovës, Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org